

Profili i Migracionit

2016

Republika e Shqipërisë

Tiranë 2017

Ky dokument prezanton Profilin e Migracionit në Republikën e Shqipërisë për vitin 2016. Hartimi dhe publikimi i tij është mbështetur në piken 4, të nenit 141, të Ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar. Informacioni i mbledhur dhe analiza e të dhënave për përgatitje e këtij Profili është siguruar nga burime zyrtare. Profili i Migracionit, i miratuar me urdhër të Ministrit të Punëve të Brendshme gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Shtetit Shqiptar. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin në bashkëpunim me përfaqësues të Institucioneve të tjera që grumbullojnë të dhëna të fushës së migracionit. Asnjë pjesë e këtij dokumenti nuk mund të riprodhohet, kopjohet apo transmetohet në asnjë formë apo mënyrë elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjen, regjistrimin pa të drejtën e autorëve.

Ky raport analitik paraqet një vazhdimësi të procesit të iniciuar në vitin 2007 nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) për hartimin e Profilit të parë për Migracionin, për të vijuar më pas me Profilet e Migracionit për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2014 të hartuara nga Qeveria Shqiptare, asistuar nga organizma ndërkombëtare si IOM, ICMPD etj .

Profili Migracionit në formë të shkurtuar, me një numër të kufizuar të faqeve që tregojnë qartë fushat e interesit, duke synuar prioritetet dhe problemet kyçe, të përditësuar për çdo vit, është një mjet i dobishëm për politikë-bërësit, institucionet e ndryshme publike, organizatat joqeveritare, akademinë dhe personat e interesuar.

Në këtë kontekst, shprehim mirënjohje për plotësimin e të dhënave, krahasimin me kontekstet bashkëkohore ndërkombëtare dhe përputhjen e plotë të strukturës së tij me standardet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore që normojnë këtë veprimtari, si edhe me kërkesat ndërkombëtare për hartimin dhe botimin e profileve të migracionit nga përfaqësuesit e institucioneve kontribuuese:

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Drejtoria e Policisë së Shtetit
Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria për Azilin
Drejtoria e Antitrafikut

MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Migratore
Shërbimi Kombëtar i Punësimit

INSTAT

BANKA E SHQIPËRISË

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Versioni Anglisht i Profilit të Migracionit 2016 u mundësua me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin IOM në Tiranë

Tabela e Përmbajtjes

1.	INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI VENDIN	4
1.1.	SIPËRFAQJA, POPULLSIA, VENDET KUFITARE DHE VIJA KUFITARE	4
1.2.	KARAKTERISTIKAT E VENDIT	5
2.	FLUKSET E PËRGJITHSHME MIGRATORE DHE STOKU I IMIGRANTËVE.....	6
2.1.	FLUKSET MIGRATORE	6
2.2.	STOKU I IMIGRANTËVE	8
3.	MIGRACIONI I RREGULLT FOKUSUAR NË MIGRACIONIN PËR PUNËSIM.....	10
3.1.	AUTORITETET PËRGJEGJËSE SHTETËRORE	10
3.2.	KUADRI LIGJOR	10
3.3.	STATISTIKAT	12
4.	MIGRACIONI I PARREGULLT NË VEND.....	17
4.1.	AUTORITETET PËRGJEGJËSE	17
4.2.	KUADRI LIGJOR	17
4.3.	STATISTIKAT	18
5.	KTHIMI, RIPRANIMI DHE RI-INTEGRIMI.....	21
5.1.	AUTORITETET PËRGJEGJËSE	21
5.2.	KUADRI LIGJOR	22
5.3.	STATISTIKA	22
6.	INTEGRIMI	28
6.1.	AUTORITETET PËRGJEGJËSE	28
6.2.	KUADRI LIGJOR	28
6.3.	STATISTIKA	28
7.	MIGRACIONI DHE ZHVILLIMI	30
7.1.	AUTORITETET PËRGJEGJËSE	30
7.2.	KUADRI LIGJOR	30
7.3.	STATISTIKA	31
8.	AZILI DHE MBROJTJA NDËRKOMBËTARE.....	35
8.1.	AUTORITETET PËRGJEGJËSE	35
8.2.	KUADRI LIGJOR	35
8.3.	STATISTIKA	36

1. Informacion i përgjithshëm mbi vendin

1.1. Sipërfaqja, popullsia, vendet kufitare dhe vija kufitare



Emërtimi Zyrtar	Shqipëria
Kryeqyteti	Tirana
Sipërfaqja	28,748 km ²
Popullsia	4 329 326 (regjistruar sipas RGJCK) 2 876 101 (Popullsia mesatare 2016, sipas INSTAT)
Gjuha:	Gjuha zyrtare në Shqipëri është gjuha shqipe. Në territoret e banuara nga minoritetet, përveç gjuhës shqipe, flitet dhe gjuha greke, serbo-kroate dhe maqedonase.
Kufiri dhe shtete kufitare:	Gjatësia e përgjithshme: 1079 km (tokësor: 717 km; detar: 362 km); Shtetet kufitare: Mali i Zi 151 km, Kosove 112 km, Maqedoni 172 km, Greqia 282 km)

1.2. Karakteristikat e vendit

Shqipëria është republikë parlamentare, me tre degët e pavarura të qeverisjes – legjislativi (Parlamenti), ekzekutivi (qeveria) dhe gjyqësori (gjykatat). Shqipëria ka një ndarje territoriale në 12 qarqe me kryeqytet Tiranën.

Megjithëse në nivel qeveritar nuk ka një strukturë koordinuese apo lider mbi migracionin, kompetencat administrative në fushën e migracionit janë të ndërthurura dhe të shpërndara ndërmjet strukturave qeveritare dhe organeve të tjera shtetërore, të drejtat dhe obligimet e të cilave janë të shprehura në thelb të Kushtetutës Shqiptare dhe akteve të ndryshme ligjore dhe nënligjore.

Ministria e Punëve të Brendshme ka përgjegjësinë kryesore në fushën e migracionit dhe azilit. Nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme, autoritetet më të rëndësishme në zbatim janë: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtoria për Azilin.

Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për trajtimin e të huajve, janë shprehur në ligjin 108/2013 "Për të huajt", i ndryshuar. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë mbulojnë aspekte të migracionit për punësim dhe integrimin e të huajve. Marrëdhëniet me komunitetet shqiptare jashtë vendit janë në fokusin e Ministrisë së Punëve të Jashtme nëpërmjet shërbimit konsullor dhe sektorit për diasporën.

Migracioni, si një problem i mprehtë global, evropian, rajonal dhe kombëtar, përbën një aspekt të rëndësishëm të marrëdhënieve të Republikës së Shqipërisë me vendet fqinje, vendet anëtare të Bashkimit Evropian e me gjerë, si dhe një sfidë serioze në kuadër të përpjekjeve të Shqipërisë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Përgjithësisht Shqipëria vazhdon të konsiderohet si një vend origjine i emigrantëve ekonomikë, vend transit dhe destinacioni për imigrantët ekonomikë, azilkërkuesit dhe refugjatët. Migrimi në kontekstin shqiptar vazhdon të karakterizohet më shumë nga emigrimi ndërkombëtar i popullsisë vendase dhe më pak nga imigrimi i të huajve në vend. Me fillimin e mijëvjeçarit të ri, modelet e migracionit dhe qëndrimi i shqiptarëve ndaj tij kanë ndryshuar për shkak të politikave shtrënguese të vendeve pritës edhe intensifikimit nga Shqipëria të luftës kundër migracionit të parregullt.

Gjatë vitit 2016 nga Shqipëria më shumë u larguan emigrantë shqiptarë sesa hynë imigrantë. Koeficienti i migracionit neto shënoi një rritje, nga -7,2 persona për mijë banorë në 2015, në -3,3 persona për mijë banorë në 2016. Migracioni neto (diferenca midis imigrantëve dhe emigrantëve), pësoi një tkurrje si pasojë e uljes së numrit të emigrantëve nga rreth 41 mijë në rreth 33 mijë dhe rritjes së numrit të imigrantëve nga rreth 21 mijë në rreth 23 mijë gjatë 2015-2016. Kjo rritje i atribuohet më së shumti rënies së fluksit të emigrantëve.

Komunitetet Shqiptare Jashtë Vendit aktualisht përbëhen nga pesë grupe kryesore:

- i) emigrantët ekonomikë;
- ii) prestatët e familjeve të emigrantëve ekonomikë;
- iii) studentët;
- iv) azilkërkuesit dhe refugjatët;
- v) fëmijët e pashoqëruar.

Grupet më të mëdha të këtij komuniteti përbëhen nga emigrantët ekonomikë, pjesëtarët e familjeve të emigrantëve ekonomikë dhe studentët.

2. Flukset e përgjithshme migratore dhe stoku i Imigrantëve

2.1. Flukset Migratore

Pas vitit 1990 Shqipëria është dominuar nga cikle migruese, të cilat mund të konsiderohen intensive, të parregullta dhe evoluese, si pasojë e veprimit të kombinuar të faktorëve shtytës ekonomikë dhe politikë. Gjate gjithë periudhës evidentohet një fluks i vazhdueshëm migrimi i shqiptarëve drejt Greqisë, Italisë, vendeve të tjera të BE-së, ShBA-së dhe Kanadasë.

Shqipëria mbart ende potencial të lartë migrator, favorizuar nga afërsia kulturore, gjuhësore dhe gjeografike, nga kostoja e ulët e emigrimit në vendet fqinje si Italia dhe Greqia si edhe nga mundësitë ligjore për bashkim familjar në vendet kryesore pritëse të emigrantëve.

Ndër faktorët kryesorë të emigrimit të shtetasve shqiptarë dominojnë ato me natyrë ekonomike si papunësia dhe varfëria.

Papunësia, veçanërisht te të rinjtë, ushqen flukset migratore. Tregu shqiptar i punës gjatë vitit 2016 u karakterizua nga një rënie e shkallës së papunësisë krahasuar me një vit më parë. Në fund të vitit 2016 papunësia ishte rreth 15.2%. Gjatë vitit 2016, popullsia e grup moshës 15-29 vjeç vazhdon të ketë ndikimin më të madh në nivelin e papunësisë, pavarësisht se ky tregues, për këtë grup moshë, u ul me 4,3 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Shkalla e papunësisë për këtë grup moshë në vitin 2016 arriti në 28,9 % (29,7 % për meshkujt dhe 27,8 % për femrat) nga 33,2 % (32,3 % për meshkujt dhe 34,7 % për femrat) që ishte një vit më parë. Për popullsinë e grup moshës 30-64 vjeç niveli i papunësisë është ulur në 11,8 % nga 12,5 % që ishte në vitin 2015. Të rinjtë e grup moshës 15-29 vjeç të cilët nuk janë as në punësim e as duke vazhduar shkollën apo ndonjë trajnim përbëjnë 30,0 % të të rinjve gjithsej të papunë për vitin 2016.¹

Referuar te dhënave zyrtare të grumbulluara nga përfaqësitë diplomatike shqiptare jashtë vendit, numri i shtetasve shqiptarë të emigruar jashtë rezulton si në tabelën 2.1.

Tabela 2.1. Lista e 20 shteteve me emigrim me të larte të shqiptarëve – viti 2016

Nr.	Shteti	Shtetas shqiptare
1	Itali	467 687
2	Greqi	354 456
3	SH.B.A.	250 000
4	Mbretëri e Bashkuar	50 000
5	Gjermani	48 538
6	Kanada	28 270
7	Australi	25 000
8	Turqi	6 000
9	Francë	5 588
10	Belgjikë	5 000


¹Burimi: Instat, 2017.11

11	Suedi	4 100
12	Austri	4 000
13	Holandë	2 569
14	Mali i Zi	2 060
15	Kosovë	2 000
16	Emiratet e Bashkuara	2 000
17	Zvicër	1 581
18	Spanjë	1 300
19	Rumani	1 000
20	Norvegji	956

Burimi: Ministra e Punëve të Jashtme, Tiranë, 2017

Sipas Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, rezultoi se popullsia e Shqipërisë gjatë vitit 2016 ishte 4 329 326 banorë. Ndërsa sipas të dhënave të INSTAT popullsia mesatare në vitin 2016, ishte 2 876 101 banorë. Diferenca midis të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe popullsisë mesatare për vitin 2016, mund të vlerësohet në mënyrë të tërthortë si tregues për numrin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Pra, Shqipëria kishte në vitin 2016 rreth 1.4 milion shtetas jashtë territorit të saj, ose rreth 1/3 e popullsisë së vendit.

Figura 2.1. Dinamikat e migracionit, 2012-2016 (Migracioni neto = Imigrantë – Emigrantë)



Burimi: INSTAT, 2017

Flukset migratore të shtetasve të huaj në Shqipëri rezultojnë të ulëta në krahasim me popullsinë banuese apo atë migruese. Gjatë dekadës së fundit, numri i përgjithshëm i shtetasve të huaj që

qëndrojnë në Shqipëri ka mbetur përafërsisht në nivelin 0.3 % të popullsisë vendase dhe origjina e imigrantëve legalë nuk ka shënuar ndryshime të theksuara. Në tabelë paraqiten të dhënat mbi të huajt rezidentë në Shqipëri krahasuar me popullsinë banues dhe migruese .

Tabela 2. 2. Flukset Migratore , 2015-2016


	2015	2016
Popullsia mesatare vjetore në Shqipëri	2,880,703	2,876,101
Imigrantë të regjistruar	10563	12519

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2017(të dhëna të përpunuara)

2.2. Stoku i Imigrantëve

Më 1 janari 2017, numri i shtetasve të huaj që banojnë në Shqipëri ishte **12519**, ose rreth 0.4 % e popullsisë. Në vitin 2016, të huaj nga vendet evropiane zinin 66%, ndërkohë që 5.6 % vinin nga kontinenti amerikan (Veriut&Jugut), 26 % nga kontinenti aziatik, 1.8% nga Afrika dhe numri i imigrantëve nga vende të tjera ishte i papërfillshëm.

Figura 2.2. Të huajt të regjistruar në Shqipëri sipas prejardhjes nga kontinentet me 1 Janar 2017




Burimi: Sistemi FER-TIMS në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, Tiranë, 2017

Prurjet migratore të shtetasve të vendeve të rajonit në kufi me Shqipërinë (Kosove – Maqedoni – Mal i Zi – Serbi) kryesisht janë dominuar nga ata me etni shqiptare. Ndërmjet imigrantëve evropianë në tërësi për vitin 2016, 22 % (1854) ishin Italianë, 47 % (3954) ishin të shtetësisë Turke, 9% (719) ishin nga Kosova dhe afërsisht 22% erdhën nga vende të tjera të Evropës. Pothuaj 70% e imigrantëve aziatikë e përbënin shtetas azilkërkues nga Irani, 10% erdhën nga Kina (331 persona), 6 % nga Siria (184) dhe 3% erdhën nga India (101). Imigrantët nga SHBA përbënin 63 % të imigrantëve amerikanë (441 persona), ndërsa imigrantët nga shtete afrikane zinin afërsisht 2 % (223 persona) të numrit total të imigrantëve (12519) për vitin 2016.

Referuar vendit të origjinës dhe gjinisë së shtetasve të huaj, në figurën në vijim paraqitet stoku i imigrantëve që jetojnë në Shqipëri për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 .

Figura 2.3. Të huaj rezidentë në Shqipëri sipas origjinës dhe gjinisë, 2015- 2016



Burimi: Sistemi FER-TIMS në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Tiranë, 2017.

3. Migracioni i rregullt fokusuar në migracionin për punësim

3.1. Autoritetet përgjegjëse shtetërore

Ministria e Punëve të Brendshme nëpërmjet strukturave, si Policia e Shtetit (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin), Drejtoria për Azilin etj., është përgjegjëse kryesore për menaxhimin e migracionit dhe integrimin e tij. Si autoriteti përgjegjës për trajtimin e të huajve që hyjnë, tranzitojnë apo qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në varësi të Policisë së Shtetit, i organizuar në nivel qendror dhe vendor, ka përgjegjësi për kontrollin e të huajve dhe marrjen e vendimeve në procedurat e aplikimit për vizë të të huajve për të hyrë në Republikën e Shqipërisë; kontrollit kufitar duke zbatuar kushtet dhe kriteret për të hyrë, qëndruar dhe tranzituar në Republikën e Shqipërisë; pajisjen e të huajve me leje qëndrimi apo zgjatjen e qëndrimit etj.

Ministria e Punëve të Jashtme është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikës së vizave si dhe negocimin e akteve të nevojshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e migracionit; mbështetjen e emigrantëve shqiptar jashtë vendit dhe mbrojtjen të drejtave të tyre, organizimin e diasporës shqiptare, etj.

Drejtoria e Çështjeve Konsullore është struktura përgjegjëse në **Ministrinë e Punëve të Jashtme** për trajtimin e të huajve, hartimin e politikave të hyrjes e qëndrimit të tyre në RSH. Kjo drejtori harton politikat e aktivitetit e shërbimit konsullor, monitoron dhe drejton këtë aktivitet.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinise, nëpërmjet Drejtorive në përbërje të saj dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin përkatës, në fushën e zhvillimit dhe monitorimit të politikave shtetërore për emigracionin me lidhje me punësimin, arsimin dhe formimin profesional, standardet sociale, pensionet, familjen, fëmijët dhe politikat rinore etj. Ky institucion është përgjegjëse për lejimin e punësimit të të huajve në çdo kohë, përfshirë edhe profesionet.

3.2. Kuadri Ligjor

Politika migratore shqiptare është e shprehur në Kushtetutë, si kornizë garantuese e të drejtave dhe lirive të të huajve, e rregulluar me anë të legjislacionit në fuqi, akteve nënligjore, si dhe urdhrave dhe udhëzimeve përkatëse. Institucionet përgjegjëse për trajtimin e aspekteve të ndryshme të migracionit në Republikën e Shqipërisë, janë përgjegjëse për zbatimin politikave të veçanta migratore, pjesë përbërëse të politikës së përgjithshme migratore sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore me anë të të cilave është rregulluar politika migratore në Republikën e Shqipërisë.

Ndryshimi i normativës migratore gjatë viteve të fundit në frymën e legjislacionit të BE-së ka synuar ndërtimin e një platforme të re të politikave migratore, për më shumë partneritet në menaxhimin global të migracionit. Kështu kuadri ligjor shqiptar (Ligji 108/2013 "Për të huajt" i ndryshuar dhe aktet normative në zbatim të tij) ka shënuar mjaft përmirësime në aspekt të procedurave të dokumenteve të udhëtimit, vizave, punësimit, qëndrimit, bashkimit familjar etj.). Gjatë vitit 2016 u miratua Ligji nr.74, datë 14.07.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2013 "Për të

huajt", dhe Udhëzimi i Përbashkët nr. 264, date 11.01.2016 mbi bashkëpunimin e strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Informativ të Shtetit, për procedurën e lëshimit të vizave për të huajt.

Menaxhimi i migracionit trajtohet në një seksion të veçantë të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2025 (SKZHI). SKZHI vëren se pavarësisht progresit në menaxhimin me efektivitet të migracionit në Shqipëri, pas zbatimit të Strategjisë së parë Kombëtare për Migracionin (2005-2010) dhe Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer (2010-2015), disa sfida mbeten të pa trajtuara: (i) Parandalimi i migrimit të parregullt nga vendi, keqpërdorimin e regjimit pa viza në zonën Shengen të BE-së; (ii) Kthimi i qëndrueshëm i shqiptarëve përmes ofrimit të mbështetjes për riintegrim; (iii) ndikimi i zhvillimit të migrimit duhet të forcohet, ndër të tjera me anë të promovimit të investimeve njerëzore dhe financiare të shqiptarëve që janë jashtë vendit për vendin; (iv) forcimi i strukturave të menaxhimit të migracionit dhe politikave paraprake të imigracionit dhe zbatimi i tyre bazuar në fakte solide dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë sigurimin e të drejtave të njeriut të të gjithë emigrantëve.

Vizioni i SKZHI konsiston në krijimin e një sistemi efektiv të qeverisjes së migracionit në Shqipëri, përmes realizimit të objektivave të mëposhtëm strategjikë:

1. Nxitja e kanaleve të sigurta dhe të rregullta për migrimin në Shqipëri me qëllim parandalimin e migracionit të parregullt, për të kanalizuar 70% të migrimit nga Shqipëria nëpërmjet marrëveshjeve të rregullta bilaterale;
2. Rritja e ndikimit të zhvillimit të emigrimit duke krijuar mekanizma të favorshme ligjore dhe institucionale ;
3. Rritja e qëndrueshmërinë së migracionit të kthimit me mbështetjen e riintegrimit të emigrantëve të kthyer;
4. Zbatimi i avancuar i politikave të migracionit, në mënyrë që të sigurojë trajtimin e barabartë të shtetasve të vendeve të tjera dhe integrimin e tyre në Shqipëri, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
5. Konsolidimi i politikës së migracionit, kuadrit ligjor, strukturave të menaxhimit dhe koordinimit, në mënyrë që të sigurohet reagim më i mirë ndaj sfidave të migracionit.

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014–2020, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 818, datë 26.11.2014 ka si qëllim të përgjithshëm të nxisë vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi për gjithë femrat dhe meshkujt shqiptarë gjatë gjithë ciklit të jetës. Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi përqendrohet në katër përparësitë strategjike: nxitja e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës, ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit, nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial dhe fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimeve. Strategjia përfshin shumë masa dhe aktivitete që synojnë menaxhimin e migracionit të rregullt për punësim të shtetasve shqiptarë jashtë vendit, migrimin e kthimit, si dhe imigracionin për punësim të shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë. Në këtë drejtim, Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 – 2020 dhe plani i saj i veprimit synojnë:

- a) fuqizimin e kapaciteteve informuese dhe këshilluese për emigrimin e rregullt për punësim
- b) përmirësimin e infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve për emigrantët
- c) fuqizimin e agjencive private të punësimin
- ç) rritjen e bashkëpunimit me vendet e tjera për menaxhimin e emigrimit për punësim nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe të punës
- d) njohjen e kualifikimeve profesionale dhe eksperiencës profesionale të fituar jashtë vendit,
- e) përafrimin e vazhdueshëm të legjislationit të imigrimit të punës me atë të Bashkimit Evropian.


Politikat dhe shërbimet migratore të Ministrisë së Punëve të Jashtme përfshijnë ndër të tjera përmirësimin dhe trajtimin e të huajve në Shqipëri, nëpërmjet garantimit të të drejtave të të huajve kur vijnë në Shqipëri dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera që trajtojnë të huaj dhe lehtësimin të kushteve të ardhjes të të huajve në Shqipëri nëpërmjet heqjes së vizave sezonale dhe përmirësimeve procedurale në dhënien e vizave.

3.3. Statistikat

Arsyet më të zakonshme të aplikimeve për leje qëndrimi të shtetasve të huaj në Shqipëri janë aktivitete fitimprurëse, bashkimi familjar dhe studim. Numri i kërkesave për të përfituar një leje qëndrimi në Shqipëri për vitin 2016 ka mbetur i njëjtë megjithëse stoku migrator ke pësuar një rritje prej 18 % krahasuar me vitin 2015.

Gjatë vitit 2016, numri i përgjithshëm i shtetasve të huaj që qëndrojnë në Shqipëri ka mbetur përafërsisht në nivelin 0.4 % të popullsisë vendase. Gjithashtu numri dhe origjina e shtetasve të huaj që kanë aplikuar për leje qëndrimi nuk ka shënuar ndryshime të theksuara. Në vitin 2014, imigrimi nga vendet evropiane zinte 75%, ndërkohë që 13 % vinin nga kontinenti amerikan, 10 % nga kontinenti aziatik dhe numri i emigrantëve nga shtete të tjera ishte i papërfillshëm, rreth 1-2 %. Në vitin 2015, rreth 75% të imigrantëve e përbënin ata me origjinë evropiane, 16% nga Azia, 6 % nga Amerika dhe 2% nga Afrika. Në vitin 2016, 57% të imigrantëve e përbënin ata me origjinë evropiane, 32% aziatike, 5 % amerikane dhe vetëm 2% afrikane. Në figurë paraqiten të dhënat mbi të huajt që kanë aplikuar për leje qëndrimi në Shqipëri për 10 shtetësitë kryesore.

Figura 3.1. Aplikime për leje qëndrimi të të huajve sipas shtetësisë, 2015-2016



Burimi: Sistemi FER-TIMS në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, Tiranë, 2017.

Referuar të dhënave të Regjistrimit Elektronik për të huajt, konstatohet një dominim i shtetasve italianë dhe turq që vijnë në Shqipëri për motiv punësimi. Kështu ndërmjet imigrantëve evropianë për vitin 2016, përafërsisht 21% ishin Italianë, 13% ishin turq dhe 9% ishin nga Kosova. Prurjet migratore nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia për vitin 2016 vijnë të dominohen nga ata me kombësi shqiptare.


Tabela 3.1. Të huaj rezident në Shqipëri sipas 10 shtetësive kryesore 2015,2016

Shteti	2015	2016
Turqi	1199	1032
Itali	1584	1694
Kosove	806	730
Greqi	250	229
SHBA	206	221
Kanada	131	107
Kine	174	215
Maqedoni	180	177
Gjermani	100	136
Mbretëri e Bashkuar	129	118

Burimi: Sistemi FER-TIMS në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, Tiranë, 2017.

Sipas të dhënave të Regjistrat Elektronik për të Huajt (FER), gjatë vitit 2016 u përpunuan 8692 aplikime të shtetasve të huaj për leje qëndrimi. Në figurën e mëposhtme paraqitet dinamika e kërkesave për leje qëndrimi në Shqipëri në vitet 2015 dhe 2016 sipas gjinisë ku vërehet një dominim i gjinisë mashkull 50% më shumë se femra..


Figura 3.2. Të huaj trajtuar me leje qëndrimi sipas gjinisë (2015-2016).



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2017

Sipas motivit të qëndrimit, numrin më të madh të të huajve e përbëjnë ata që qëndrojnë në Shqipëri për motive punësimi, me afat mbi 12 muaj, kryesisht meshkuj, përqendruar në kryeqytet, Tiranë. Të dhënat për të huajt që aplikuan për leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë sipas motivit të qëndrimit, gjatë vitit 2016 krahasuar me vitin 2015, janë paraqitur në figurën e mëposhtme.

Figura 3.3. Të huajt trajtuar me leje qëndrimi sipas motivit, 2015, 2016



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë, 2017

Në lidhje me të huajt që vijnë në Shqipëri për qëllime punësimi, evidentohet rritje e kërkesës për punësim kryesisht nga shtetas Italianë (1694 aplikime), Turq (1032 aplikime), Kosovarë (730 aplikime) etj, ndërsa numri i të huajve të vetëpunësuar në vitin 2016 ishte 8 % e numrit të përgjithshëm, ku dominojnë shtetasit Italianë, turq dhe sirianë.

Rajoni që ka pasur fluksin më të madh të shtetasve të huaj të pajisur me leje pune, për vitin 2016, ka qenë Tirana, me rreth 73.4% të të huajve që kanë aplikuar për leje pune në Shqipëri.

Sipas burimeve të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, vendin e parë e zënë kërkesat për leje pune për kategorinë e punëmarrësve, (1,300 për vitin 2015 dhe 1540 leje pune për vitin 2016).

Në vend të dytë janë kërkesat e të vetë punësuarve (203 për vitin 2015 dhe 284 leje pune për vitin 2016). Referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimi, lëshimi i lejeve të punës sipas Drejtorive Rajonale paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela 3.2. Shpërndarja e lejeve të punës së lëshuara për të huajt, sipas Zyrave të Punës

Shpërndarja e lejeve të punës	2015	2016
DRSHKP –Tirane	38%	39.2%
DPSHKP	27.1%	37.7%
DRSHKP- Lezhe	7.8%	0.1%
DRSHKP- Fier	6.3%	5.1%
DRSHKP-Shkodër	1.1%	1%
DRSHKP-Durrës	5.9%	4.2%
DRSHKP Elbasan	4.9%	2.3%
Total	1711	1825

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e SHKP, Tiranë, 2017

Sektorët më të kërkuar për punësimin e të huajve janë:

- ndërtimi (32.3% në 2015 dhe 19.5% në vitin 2016),
- shërbimet (15.7% në 2015 dhe 18.3% në vitin 2016),
- tregtia (9% në 2015 dhe 8.3% në vitin 2016).

Sipas shtetësisë, vendin e parë e zënë shtetasit nga vendet jo anëtare të BE-së:

- turq (51.8% në 2015 dhe 31.6% në vitin 2016)
- kinezë (10.9% në 2015 dhe 10.7% në vitin 2016)
- maqedonas (4,6% në vitin 2015 dhe 6.7% në vitin 2016).

Tabela 3.3. Lëshimi i lejeve të punës, kategorizuar sipas shteteve për vitet 2015 dhe 2016

	2015		2016	
	LP	%	LP	%
Turqi	888	51.8	659	36.1
Kine	188	10.9	197	10.7
Kanada	95	5.5	90	4.9
India	57	3.3	72	3.9
Serbia	45	2.6	35	1.9
Egjipti	44	2.57	35	1.9
Total	1711		1825	

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e SHKP, Tiranë, 2017

Të huajt e pajisur me Leje Pune janë më së shumti meshkuj. Ndërsa në vitin 2015, të huajt e gjinisë mashkull zinin 89.5% të numrit të përgjithshëm të të huajve të punësuar në Shqipëri, në vitin 2016 ata zinin 88%.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2016, janë pajisur me vërtetim deklarimi për punësim (VDP) **1834** të huaj, si më poshtë:

Sipas gjinisë: janë pajisur me VDO, 423 femra dhe 1411 meshkuj;

Sipas shtetësisë: renditen të parët shtetasit nga Italia (790 VDP), Kosova (211 VDP), Greqia (135 VDP).

Sipas sektorëve: në fushën e aktiviteteve të tjera të shërbimit janë pajisur me VDP 333 të huaj; në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, riparim mjetesh motorike dhe motoçikletash janë pajisur me VDP 123 të huaj; në sektori i ndërtimit janë pajisur me VDP 180 të huaj; vullnetarët dhe misionarët fetarë janë pajisur me VDP 301 të huaj;

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2016, janë pajisur me Certifikatë Regjistrimi në Punë (CRP), **228** të huaj, si më poshtë:

Sipas gjinisë: janë pajisur me CRP 45 femra dhe 183 meshkuj.

Sipas shtetësisë: renditen të parët shtetasit nga Turqia (72 CRP), shtetasit nga Kina (36 CRP), Kanadezë (9 CRP) dhe Koreanë (12 CRP);

Sipas statusit profesional: Për vullnetarët dhe misionarët fetarë janë lëshuar 95 CRP; për teknikë janë lëshuar 39 CRP dhe për menaxherë janë lëshuar 21 CRP.

Gjatë vitit 2016 janë përjashtuar nga detyrimi për tu pajisur me leje pune 228 të huaj, krahasuar me 274 të huaj në vitin 2015.

Pjesa më e madhe e përjashtimeve për vitin 2016 janë rezidentë në Tiranë (53.9%), në Elbasan (20.1%), Rrëshen (6.1%) dhe Lezhë (3.5%).²

Punëmarrësit e huaj, pa leje pune, sipas treguesve statistikorë të inspektimeve, përbënin 4% në 2013, 1% në 2014, 0.8% në vitin 2015 dhe 1.8% në vitin 2016.

² Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Migratore MMSR, Tiranë, 2017

4. Migracioni i parregullt në vend

4.1. Autoritetet Përgjegjëse

Ministria e Punëve të Brendshme nëpërmjet strukturave, si Policia e Shtetit (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, departamenti Kundër Krimit të Organizuar dhe Kundër Krimeve të Renda), Drejtoria për Azilin, Drejtoria Antitrafik etj., ka përgjegjësinë kryesore në fushën e migracionit të parregullt. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin nëpërmjet strukturave të saj qendrore dhe vendore, është përgjegjëse për parandalimin dhe luftën e migracionit të parregullt nëpërmjet menaxhimit të integruar të kufijve; kontrollit të ligjshmërisë së qëndrimit të të huajve në territor dhe marrjen e masave të largimit vullnetar, dëbimin, ndalimin e të huajve të parregullt në territor dhe kthimin e tyre në vendin e origjinës apo në vendin tranzit nga kanë ardhur; zbatimin e Marrëveshjeve të Ripranimit me vendet e tjera; pritjen, intervistimin e shtetasve të kthyer në kufi, si dhe informimin e tyre mbi mundësitë e riintegritimit në vend; bashkëpunimit rajonale dhe më gjerë në fushën e shkëmbimit të të dhënave statistikore mbi migracionin a paligjshëm dhe paralajmërimin e hershem; përzgjedhjen e të huajve të parregullt në kufi a territor dhe referimin e tyre në mekanizmin përkatës; identifikimin dhe trajtimin e viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit të personave në zbatim të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe Procedurave Standarde të Veprimit për identifikimin, referimin dhe asistimin e viktimave / viktimave të mundshme të trafikimit; përfshire dhe të miturit e pashoqëruar, për luftën kundër trafikimit dhe kontrabandimit të personave.

Me qëllim kontrollin dhe menaxhimin efektiv të migracionit të parregullt, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin bashkëpunon dhe ndërvepron me Drejtorinë e Azilit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, e cila mbulon çështjet për azil, refugjatët në Shqipëri. Kjo drejtori është autoriteti përgjegjës vendim marrës për azilin dhe refugjatët një strukturë përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët. Ajo është përgjegjëse për trajtimin e aplikimeve, procedimin, shqyrtimin e dëgjimeve dhe grumbullimin e të dhënave të tjera të nevojshme për plotësimin e dokumentacionit për çdo aplikim për azil.

Drejtorja Antitrafik merret vetëm me monitorimin, bashkërendimin, nxitjen dhe orientimin e veprimtarisë së strukturave qendrore/vendore në çështjet e parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të personave, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Personave.

4.2. Kuadri Ligjor

Kuadri ligjor shqiptar (Ligji 108/2013 "Për të huajt" i ndryshuar, dhe aktet normative në zbatim të tij) ka shënuar mjaft përmirësime dhe në aspekt të procedurave për trajtimin e të huajve të parregullt si: luftës kundër migracionit të paligjshëm, përfshirë të miturit e pashoqëruar, hyrjen e paligjshme, qëndrimin e paligjshëm, punësimin e paligjshëm, martesat fiktive, përgjegjësitë e transportuesit etj.

Ligji i azilit me nr. 121 i vitit 2014, përafuar pjesërisht me një sërë Direktivash të Këshillit dhe Parlamentit Evropian, ka për qëllim parashikimin e kushteve e të procedurave për dhënien dhe heqjen e azilit, mbrojtjen plotësuese dhe mbrojtjen e përkohshme në Republikën e Shqipërisë, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, refugjatëve e të personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese, përmbajtjen e statusit të refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese, të drejtën për bashkim familjar, si dhe përcaktimin e kushteve për integrimin e refugjatëve e të personave nën mbrojtje

plotësuese në Republikën e Shqipërisë.

Ndër politikat migratore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, mund të veçohet Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2014-2020 dhe Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2014-2017.

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2014-2020, miratuar me VKM Nr. 119, datë 05.03.2014, është konceptuar për bashkërendim dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë autoriteteve dhe agjencive të përfshira në sigurinë kufitare dhe lehtësimin e tregtisë, me qëllim përsosjen e sistemeve të efektshme dhe me rendiment të menaxhimit të integruar të kufirit, me synim arritjen e qëllimit për të pasur kufij të hapur por të kontrolluar dhe të sigurt. Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2014-2017, bazohet në katër shtylla: i) ndjekja penale, ii) mbrojtja nga trafikimi i viktimave, iii) parandalimi, iv) bashkërendimi dhe koordinimi i punës ndërmjet institucioneve.

4.3. Statistikat

Gjatë vitit 2016, pati një ulje të numrit të shtetasve huaj, të kapur në tentativë për të kaluar në mënyrë të paligjshme transit nëpër Shqipëri. Numri i shtetasve të kapur gjatë këtij viti (915) ishte rreth 55 % më i ulët se numri i shtetasve të huaj të kapur një vit më parë (2047). Në vitin 2015 rreth 25.4 % e të huajve u kapën në brendësi të territorit, ndërsa 74.6 % në afërsi të kufirit shtetëror dhe në PKK. Ndërsa gjatë vitit 2016 vërehet se rreth 25.4% e shtetasve u kapën në brendësi të territorit, ndërsa 74.6% në afërsi të kufirit shtetëror.

Numri i shtetasve të huaj imigrantë të parregullt, që u kapën duke hyrë në mënyrë ilegale nëpërmjet kufirit të gjelbër me Greqinë, gjatë vitit 2016 ishte 663. Krahasuar me vitin 2015 ku numri ishte 1629 rezulton se shifrat kanë pësuar një rënie me 966 imigrantë të parregullt më pak.

Shtetasit e huaj imigrantë të parregullt, që kanë preferuar të përdorin për të kaluar tranzit territorin e Shqipërisë kryesisht ata shtetas që janë gjendur në pjesën e Janinës dhe Igumenicës në Greqi. Shtetasit e huaj imigrantë të parregullt të cilët janë kapur nga personeli i kufirit dhe migracionit kanë deklaruar se qëllimi i tyre është kalimi tranzit nëpërmjet vendit tonë me destinacion, vendet e BE – së.

Ata kanë deklaruar para autoriteteve lokale të kufirit dhe migracionit, se qëllimi i tyre është kalimi tranzit nëpërmjet vendeve të Ballkanit (Shqipëri, Mali Zi, Bosnje Hercegovinë, Kroaci) me destinacion përfundimtar vendet e BE-së dhe mundësisht Gjermaninë.

Tabela 4.1. Të huaj të evidentuar të parregullt sipas vendit të konstatuar, 2015 - 2016

Të huaj të parregullt	2015	2016
Në zone kufitare	1527	663
Në territor	520	252
Totali	2047	915

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2017

Për sa i përket origjinës së shtetasve të huaj të kapur në tentativë për kalim të paligjshëm të kufirit, numri më i lartë relativisht vjen nga Siria (310), Afganistan (273), Iran-Irak (135), Maroku (76), Pakistan (22), dhe Kongo (20) shtetas, ndërkohë që në vitin 2016 vërehet një ulje e ndjeshme në përgjithësi, në veçanti ka ulje për shtetësi si Somali, Eritrea, Guineja etj.

Tabela 4.2. Të huaj nga vendet e treta sipas shtetësisë, 2015-2016

Shtetësia/Viti	2015	2016
Algjeri	-	9
Siri	1354	310
Marok	66	76
Afganistan	-	273
Palestine	29	21
Tunizi	-	-
Pakistan	-	22
Kongo	46	20
Guinea	58	-
Somalia	118	14
Sudan	31	4
Eritrea	171	5
Nigeri	-	2
Indi	-	3
Komora	-	5
Iran-Irak	70	135
Gana	52	-
Te tjera	52	38

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2017

Numri i shtetasve të huaj të cilëve u është refuzuar hyrja sipas PKK-ve (tokësore, ajrore, detare) dhe sipas viteve 2012 - 2016, pasqyrohet në tabelë .

Tabela 4.3. Të huaj refuzuar në hyrje sipas llojit të PKK, 2015- 2016

Kufiri/Viti	2015	2016
Tokësor	290	273
Ajror	327	162
Detar	12	2
Shuma	629	437

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2017

Referuar të dhënave në tabelën në vijim, refuzimet kanë ndodhur për arsye të mungesës së dokumenteve të udhëtimit dhe të automjeteve, dokumente të pavlefshme, mungesës së vizës, tejkalimit të afatit të qëndrimit, mungesës së mjeteve financiare, si dhe nuk justifikojnë qëllimin e udhëtimit

Tabela 4.4. Të huaj refuzuar në hyrje sipas motivit, 2015-2016

Arsyeja e refuzimit/Viti	2015	2016
Dokumentacioni pavlefshëm, mungese vize	129	164
Nuk justifikon qëllimin	311	25
Tejkalim afati qendrimi	17	-
Njoftim në sistem	10	5

Mungese mjete financiare	6	172
Te tjera	156	71
Total	629	437

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2017

Shtetasit shqiptarë dhe të huaj, që kthehen nga policitë e vendeve të tjera në kufi, u nënshtrohen procedurave të posaçme të pritjes, intervistimit dhe më pas, përzgjedhjes. Një nga qëllimet e procesit të përzgjedhjes është edhe vlerësimi i vulnerabiliteteve dhe nevojave apo treguesve të trafikimit të qenieve njerëzore. Referuar të dhënave të administruara nga Drejtoria e Antitrafikut në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për vitin 2015 rezultojnë vetëm 4 shtetase të huaja të identifikuar si viktima të mundshme të trafikimit, me shtetësi: 1 Filipineze, 1 Kosovare dhe 2 nga Mbretëria e Bashkuar.

Për vitin 2016 janë identifikuar gjithsej 95 Viktima / Viktima të mundshme trafikimi dhe tabela 4.5 i referohet statusit, grup-moshës, gjinisë dhe kombësisë së tyre.

Tabela 4.4. Viktima të trafikimit/Viktima të mundshme të trafikimit, 2016

Statusi	Viktima trafikimi	33
	Viktima te mundshme trafikimi	62
Moshë	Të rritur	51
	Fëmijë	44
Gjinia	M	11
	F	84
Kombësia	Shqiptar	87
	Të huaj	8

Burimi: Drejtoria e Antitrafikut Tiranë, 2017

Referuar të dhënave për shtetasit e huaj nga të cilët 2 meshkuj dhe 6 femra, rezultojnë të shtetësive: 2 filipineze, 2 moldave, 1 afrikan, 1 kosovar, 1 amerikane dhe 1 maqedonase.

5. Kthimi, Ripranimi dhe Ri-integrimi

5.1. Autoritetet Përgjegjëse

Ministria e Punëve të Brendshme nëpërmjet strukturës së Departamentit për Kufirin dhe Migracionin në Policinë e Shtetit, dhe Ministria e Punëve të Jashtme nëpërmjet strukturës Konsullore, kanë përgjegjësinë kryesore për hartimin e politikave për kthimin/ripranimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm në Shqipëri, si dhe për implementimin e instrumenteve juridike dypalëshe dhe shumëpalëshe (marrëveshje ripranimi), me qëllim ndjekjen dhe kryerjen e procedurave të kthim/ripranimit të shtetasve të saj, kthimet vullnetare, zbatimimi i të cilave asistohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin në Shqipëri IOM.

Zbatimimi i kthim/ripranimeve mbështetet nga oficerët e kontaktit dhe stafet konsullore shqiptare jashtë shtetit që marrin pjesë në praktikën e bashkëpunimit me autoritetet e vendeve përkatëse për të mbështetur kthimin e personave. Si rezultat i refuzimit të azilkërkimit nga shtetas shqiptarë në disa shtete të BE-së kthimet, pas përfundimit të procesit të azilkërkimit, nga një natyrë depërtuese janë konvertuar në kthime vullnetare. Bisedimet dypalëshe i kanë paraprirë fenomenit të kthimit vullnetar kryesisht, nëpërmjet fluturimeve speciale, nga shtete të BE-së si Gjermania, Franca, Britania e Madhe, Suedia, etj. Shumë fluturime të kësaj natyre koordinohen nga Frontex (Agjencia Evropiane e Menaxhimit të Kufijve dhe Rojës Bregdetare).

Në procesin e riintegritimit janë të përfshira shumë institucione të nivelit qendror dhe vendor që merren me zbatimin e politikave për ri-integrimin e personave të ri-atdhesuar. Institucionet në nivelin qendror të përfshira në zbatimin e politikave të riintegritimit janë: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, është përgjegjëse për riintegritimin e shtetasve shqiptarë të kthyer, konkretisht në:

- Përfshirjen e kategorisë së shtetasve shqiptarë të kthyer me probleme ekonomike, në grupet e veçanta të punëkërkuesve të papunë që përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit;
- Identifikimin e nevojave ekzistuese për formimin profesional të shtetasve shqiptarë të kthyer;
- Ofrimin e trajnimeve falas në drejtoritë rajonale të formimit profesional publik të shtetasve shqiptarë të kthyer me probleme ekonomike;
- Ngritjen dhe funksionimin e "Sporteve të Migracionit" në të gjitha Zyrat Vendore të Punësimit;
- Bashkërendimin e punës për zbatimin e politikave në fushën e riintegritimit të emigrantëve të rikthyer, si dhe
- Në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore, përgjigjet për sigurimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, si dhe për mbështetjen për plotësimin e kërkesës për përfitimin e ndihmës ekonomike për emigrantët e rikthyer.

Ministria e Arsimit dhe Sportit është përgjegjëse për të kontribuar në integritimin e shtetasve të huaj dhe shqiptarëve të kthyer në Shqipëri në fushën e arsimit, kulturës dhe shkencës.

5.2. Kuadri Ligjor

Në fushën e adresimit të migrimit ilegal duke siguruar kthimin efikas dhe të qëndrueshëm, për Shqipërinë vazhdon të jetë prioritet në veçanti kthimi vullnetar. Në përputhje me Direktivën e Kthimit, politika e kthimit në Shqipëri mbështet kthimin vullnetar të personave të cilët janë subjekt i një detyrimi për tu larguar nga territori i Shqipërisë. Politikat e kthimit, ripranimeve dhe riintegritit të qëndrueshëm të të kthyerve; politika e largimeve, dëbimeve, ndalimeve; politika e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të imigrantëve dhe mbrojtjes së të dhënave personale; politika dhe masat represive dhe ankimit; politika e integritit të imigrantëve, etj, janë të shprehura në normativën ligjore për të huajt (Ligji 108/2013 "Për të huajt" i ndryshuar me Ligjin 74/2016 dhe aktet normative në zbatim të tij). Gjatë vitit 2015 u miratua Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme nr 293, date 04.06.2015 mbi trajtimin e shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nëpërmjet Drejtorive në përbërje të saj dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin përkatës, në fushën e zhvillimit dhe monitorimit të politikave shtetërore për emigracionin dhe çështjet e lidhura me të: punësimin, arsimin dhe formimin profesional, dhe imigracionin e punës, marrëdhëniet e punës, etj.


Prej vitit 2010, në varësi të Shërbimit Kombëtar të Punësimit funksionojnë Sportelet e Migracionit (SM), të cilat janë ngritur pranë të gjitha Zyrave Vendore të Punësimit. Sportelet e Migracionit janë pjesë e rëndësishme e mekanizmit të mbështetjes për rintegrim. Këto struktura shërbejnë si pikë kyçe në nivel vendor për të mbledhur të dhëna të hollësishme për shtetasit shqiptarë të kthyer, të cilët paraqiten vullnetarisht pranë tyre. Sportelet e Migracionit kryejnë funksionet e mëposhtme: i) Intervistimi shtetasve shqiptarë të kthyer që paraqiten vullnetarisht në sportel; ii) Dhënie informacioni për shërbimet publike dhe ato private, në përputhje me nevojat e identifikuar (kur ekzistojnë); iii) Referim tek shërbimet publike dhe ato private (kur ekzistojnë) si dhe projekte specifike të shoqërisë civile në përputhje me nevojat e tyre. Politikat migratore përfshihen dhe në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014–2020.

Ministria e Punëve të Jashtme bashkërendon veprimet me strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme për zbatimin e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale të ripranimit të shtetasve.

5.3. Statistika

Në vitin 2016, nga 915 të huaj të kapur apo të konstatuar në situatë të parregullt, janë larguar me procedura ripranimi 96 persona, kryesisht drejt Greqisë. Shtetasit e kthyer/ripranuar ishin nga Siria, Afganistani, Pakistani, Maroku, etj. Për shtetasit e huaj nga vendet e treta të kapur në kufi dhe territor është aplikuar së shumti procedura e largimit mbi baza vullnetare dhe pjesërisht janë trajtuar në Qendrën e Mbyllur për të huajt Kareç duke vijuar me procedurat e kthimit mbi baza të marrëveshjeve dypalëshe mes Shqipërisë dhe vendeve të origjinës/të tranzitit.

Figura 5.1. Të huaj nga vendet e treta në Qendrën Pritëse të Mbyllur, 2015-2016



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2017

Numri i personave të trajtuar në Qendrën e Mbyllur u ul përkatësisht nga 327 në 2015, në 99 në 2016. Kjo ulje vjen si rezultat i përparësisë së trajtimit të shtetasve të huaj, subjekte të detyrimit ligjor për t'u larguar nga terrori i Republikës së Shqipërisë, me urdhra largimi që ekzekutohen mbi baza vullnetare.

Duke analizuar flukset migratore në tërësi, karakteristike për flukset migratore në Shqipëri mbetet kthimi vullnetar i shtetasve shqiptare. Ndikimin negativ i krizës ekonomike në disa vendet e BE-së, ka ndikuar në rritjen e kthimit të emigrantëve, sidomos nga Greqia dhe Italia.

Intensifikimi i kthimit të emigrantëve shqiptarë gjatë vitit 2016 është i lidhur kryesisht me vazhdimin e krizës ekonomike në vendet pritëse si dhe me kthimet e emigrantëve të parregullt.

Tipologjitë e emigrantëve shqiptarë të kthyer gjatë vitit 2016 kanë qenë:

- i) Kthim vullnetar i emigrantëve ekonomikë;
- ii) kthimi emigrantëve ekonomikë për shkak të krizës në vendet kryesore pritëse, Greqi dhe Itali;
- iii) kthimi i të miturve të shoqëruar ose jo nga prindërit;
- iv) kthimi i migrantëve të parregullt;
- v) kthimi i azilkërkuesve që nuk kanë përfituar azil.

Tabela mëposhtmen vijim paraqet numrin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga vendet e BE-së gjatë viteve të fundit, sipas grup moshave.

Tabela 5.1. Shtetas shqiptarë të kthyer sipas grup moshës për 2012- 2016

Viti	Totali	Meshkuj		Femra	
		Gjithsej	nen 18 vjeç	Gjithsej	Nen 18 vjeç
2015	25134	23592	260	1542	37
2016	21681	18443	978	2259	222

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2017

Pra, rreth 85 % e emigrantëve të kthyer në vitin 2016 kanë qenë meshkuj, kundrejt 15% femra, ndërkohë që në vitin 2015 meshkujt përbënin rreth 94% të të kthyerve. Gjithashtu, vërehet një ulje e numrit të shtetasve të kthyer për vitin 2016 rreth 14 %, krahasuar me vitin 2015, gjë që i referohet uljes së numrit të shqiptarëve që kërkojnë të qëndrojnë në vendet e BE në mënyrë të parregullt.

Për vitin 2016 evidentohet një rritje e ndjeshme e kthimit të të miturve të pashoqëruar. Tabela e mëposhtme paraqet shtetet kryesore prej nga janë kthyer të miturit shqiptarë të pashoqëruar.

Tabela 5.2. Shtetet kryesore kthyesë të të miturve të pashoqëruar, 2015-2016

Viti	2015	2016
Greçia	10	331
Franca	54	94
Britania e Madhe	1	60
Zvicër	0	28
Suedia	16	45
Gjermania	19	280
Bruksel	5	4
Norvegji	4	-
Totali	120	948

Burimi: Sistemi TIMS në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, 2017

Gjatë vitit 2016, në raport me vitin 2015, numri i kërkesave për kthim të të miturve të pashoqëruar apo të ndarë në lëvizje në vendet të BE-së u rrit. Kjo vërehet në tabelën e mëposhtme (5.3) ku për vitin 2016 gjeografia dhe numri i shteteve kthyesë është rritur.

Me qëllim adresimin e kësaj problematike të mprehtë dhe me vullnetin e mirë për të minimizuar këtë fenomen të pazakontë të të miturve të pashoqëruar apo të ndarë në lëvizje janë zhvilluar takime me përfaqësues të Agjencive të Migracionit të shteteve si Gjermania, Franca, Suedia, Belgjika, Greçia, Italia, etj. Bashkëpunimi në këtë fushë është fokusuar në marrjen e informacionit nga shtetet kërkuese si dhe në realizimin e një kthimi/ripranimit të sigurt të të miturit të pashoqëruar apo të ndarë në lëvizje pranë familjes apo të dorëzimit të tyre pranë entit shtetëror të ngarkuar me ligj për akomodimin e tyre. Bashkëpunimi i strukturave të policisë kufitare dhe migracionit me shërbimin social shtetëror, si enti kryesor shtetëror i trajtimit social të të miturve, është në nivele shumë të kënaqshme.

Tabela 5.3. Kthimi i të miturve të pashoqëruar nga vendet e BE-së me procedurë ripranimi për vitet 2015 - 2016


Shteti	Kërkesa	Të ripranuar	Kërkesa	Të ripranuar
	2015		2016	
Franca	55	24	71	47
Gjermania	19	13	81	58
Suedia	26	12	27	24
Belgjika	5	4	5	5
Norvegjia	4	4	6	6

Greqia	10	9	7	7
Anglia	1	1	4	4
Italia	-	-	17	10
Totali	120	68	218	161

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2017

Ndërkohë gjatë vitit 2016 vërehet ulje e fluksit të shtetasve shqiptarë që kërkonin azil në vendet e BE-së krahasuar me vitin 2015. Në figurën e mëposhtme paraqitet dinamika e kërkesave për azil në këto vende gjatë periudhës 2015-2016.


Figura 5.2. Shtetas shqiptarë që kanë kërkuar azil në vendet e BE-së, 2015 - 2016



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2017 (të dhëna nga EUROSTAT të përpunuara)

Vendet kryesore ku shtetasit shqiptarë kanë kërkuar azil janë Gjermania, Greqia, Holanda, Franca, dhe Mbretëria e Bashkuar. Arsye kryesore të azil kërimit kanë qenë ato ekonomike, duke çuar për rrjedhojë në nivele të larta refuzimi lartë të kërkesës për azil nga vendet e BE-së.

Figura 5.2. Shtetas shqiptarë që kanë kërkuar azil në 5 vendet kryesore sipas viteve



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, 2017 (të dhëna nga EUROSTAT të përpunuara)

Referuar Figurës 5.2, vërehet një ulje e ndjeshme e shqiptarëve që kërkojnë azil në vendet e BE, kryesisht në Gjermani.

Një pjesë e shtetasve shqiptarë që kthehen nga emigracioni paraqiten pranë Sporteve të Migracionit (SM) që ndodhen në të gjitha zyrat rajonale dhe vendore të punësimit. Në të gjithë vendin janë ngritur 36 SM. Këto struktura u ngritën në zbatim të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015 dhe Planit të saj të Veprimit. Sportelet e Migracionit intervistojnë shtetasit shqiptarë të kthyer që paraqiten në sportel, japin informacion për shërbimet publike dhe private, në përputhje me nevojat e identifikuar dhe referojnë të shërbimet publike dhe private si dhe projekte specifike të shoqërisë civile, në përputhje me nevojat e shtetasve shqiptarë të kthyer. Vetëm një pjesë e shtetasve shqiptarë që kthehen nga emigracioni paraqiten pranë Sporteve të Migracionit(SM).

Në tabelë paraqitet numri i shtetasve të kthyer, të regjistruar në SM gjatë viteve të fundit.

Tabela 5.3. Shtetas shqiptarë të kthyer të regjistruar në Sportelet e Migracionit

Viti	2015	2016
Shtetas shqiptarë	520	289

Burimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Tiranë, 2017

Në periudhën janar – dhjetor 2016, u paraqitën për t'u regjistruar dhe përfituar shërbime pranë Sporteve të Migracionit, **289 shtetas shqiptarë të kthyer nga emigracioni**.

Shtetasit shqiptarë të kthyer të paraqitur pranë Sporteve të Migracionit gjatë vitit 2016, kishin këto karakteristika :

- **Sipas moshës:** Në vendin e parë është grup moshë nga 25 – 40 vjeç me 134 të kthyer të regjistruar ose 46 % e totalit, e ndjekur nga grup moshë 40 – 55 vjeç me 117 emigrantë të kthyer të regjistruar ose 40 % e totalit.
- **Sipas nivelit arsimor:** Në vend të parë janë emigrantët me nivel arsimor të mesëm me 155 emigrantë shqiptarë ose 54 % e totalit dhe në vendin e dytë ata me arsim deri në nëntëvjeçar gjithsej 117 emigrantë ose 40 % e totalit.
- **Sipas shtetit të emigrimit:** Pjesa më e madhe janë kthyer nga shteti Grek 45 % e totalit, pasuar nga të kthyerit nga shteti Italian me 22 %. Në vend të tretë dhe të katërt të kthyerit nga vende të tjera të Bashkimit Evropian dhe Amerikës.
- **Sipas shkaqeve të kthimit:** 177 emigrantë të kthyer ose 61 % e totalit janë të kthyer për shkak të papunësisë, në vend të dytë renditen emigrantët e kthyer me mungesë dokumentacioni me 36 % dhe në vendin e tretë ata emigrantë që dëshirojnë të investojnë në Shqipëri.
- **Sipas tipit të kthimit:** Në pjesën më të madhe kthimi është familjar dhe afatgjatë. 59% e të regjistruarve janë kthyer familjarisht, pjesa tjetër janë kthyer individualisht. Nga këta 67 % e të regjistruarve janë për një kthim afatgjatë dhe 33 % e tyre janë kthyer përkohësisht.

- **Sipas mbështetjes për riintegrim:** Gjatë vitit 2016 janë këshilluar për punësim 53 % e të kthyerve, janë orientuar në kurset e formimit profesional 31 % e të kthyerve, janë mbështetur me të ardhura 16 % e tyre dhe janë mbështetur me informacion dhe referim për shërbime mjekësore 22 % e të kthyerve të paraqitur pranë sporteve të migracionit.

Në vitin 2016 u trajnuan në kurset e formimit profesional të ofruara nga Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik 48 emigrantë të kthyer. Kurset e formimit profesional të preferuara nga emigrantët e kthyer në vitin 2016 janë: estetist, hidraulik, instalues dhe riparues rrjeti, instalues të mjeteve ngrohëse – ftohëse, instalues të paneleve diellore, elektrikist dhe parukeri.

Në vitin 2016, përfituan nga programet aktive të tregut të punës gjithsej 142 emigrantë të kthyer. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.48, "Program i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë në vështirësi" u punësuan 35 emigrantë të kthyer. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.47, "Program i nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë" u punësuan 106 emigrantë të kthyer dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.873 "Praktika për student të sapo diplomuar" u punësua 1 emigrant i kthyer.

Të kthyerve në moshë shkollore trajtohen u krijohen lehtësi për përfshihen në sistemin arsimor. Referuar të dhënave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në fillimin e vitit shkollor 2015- 2016, nga të larguarit u kthyen dhe u reregjistruan rreth 801 nxënës³.

Nga të dhënat e dërguara nga DAR/ZA për regjistrimet në vitin shkollor 2015-2016, rreth 1800 nxënës të arsimit parauniversitar janë kthyer nga jashtë shtetit dhe janë reregjistruar për të vijuar mësimin në atdhe.

Përveç udhëzimeve të dhëna në fillimin e çdo viti shkollor për riintegrimin në arsim të të kthyerve, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, porositi të gjitha DAR/ZA për marrjen e masave "Për regjistrimin dhe trajtimin e nxënësve që kthehen nga emigracioni" në drejtim të:

- Regjistrimit dhe trajtimit me përparësi i nxënësve të kthyer, duke lehtësuar integrimin e tyre në shkollë dhe në komunitet.
- Hartimit të një plani të posaçëm pune nga njësia e shërbimit psiko-social në DAR/ZA për ofrimin e shërbimeve që ndihmojnë në zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësve që kthehen nga emigracioni.
- Ofrimin e kurseve falas të gjuhës shqipe për nxënësit që kthehen nga emigracioni.
- Trajtimit me plane individuale mësimore për nxënësit e regjistruar në institucionet arsimore, me qëllim që të plotësohen detyrimet e programeve lëndore për periudhën kohore të munguar prej tyre.

³ *Burimi: Ministria së Arsimit dhe Sportit, 2017*

6. Integrimi

6.1. Autoritetet Përgjegjëse

Ministria e Punëve të Brendshme ka përgjegjësinë e përgjithshme në fushën e migracionit dhe integritit, por në Shqipëri nuk ka një sistem të specializuar institucional për koordinimin e integritit dhe shtetësisë.

Fitimi i shtetësisë shqiptare bëhet me dekret të Presidentit të Republikës, por është Ministria e Punëve të Brendshme, autoriteti përgjegjës për zbatimin e politikave dhe procedurave në çështjet që ndërlidhen me shtetësinë e Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuadër janë strukturat në Policinë e Shtetit dhe Sektori për Shtetësinë në Drejtorinë Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që pranojnë aplikimin, kontrollojnë, verifikojnë dhe vendosin për t'ia kaluar këtë kërkesë Presidentit për dekretim.

Evidentohet mungese në koordinimi mes strukturave që trajtojnë procedurat për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare, me ato që trajtojnë qëndrimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë.

6.2. Kuadri Ligjor

Mbështetje për integrimin përveç personave që vijnë nga trevat shqipfolëse, është e nevojshme për emigrantët që vijnë nga vendet e treta të cilët nuk flasin shqip, për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare (refugjatëve dhe mbrojtjes plotësuese), si dhe të personave pa shtetësi. Shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri (përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, qytetarët e BE-së, të vendeve të treta) kanë të drejtë për një gamë të gjerë shërbimesh, por këto janë të fragmentuara, në varësi të motivit të qëndrimit. Nuk ka asnjë program kompleks të integritit që vlen për të gjithë të huajt.

Rregullat për fitimin e shtetësisë shqiptare rregullohen nëpërmjet ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për Shtetësinë Shqiptare" i ndryshuar me ligjin nr. 8442, datë 21.1.1999 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8389, datë 5.8.1998 "Për Shtetësinë Shqiptare". Pra sikurse mund të shikohet qartë ndryshimet e fundit ligjore kanë ndodhur në vitin 1999.

Në zbatim të dispozitave ligjore që përcaktojnë rregullat dhe kriteret për fitimin, lënien dhe rifitimin e shtetësisë Shqiptare kanë dalë në zbatim disa akte nënligjore të cilat përcaktojnë rregullat, afatet, dokumentet dhe autoritetet kompetente për shqyrtimin e këtyre kërkesave

6.3. Statistika

Vetëm një pjesë e vogël e të huajve rezidentë në Shqipëri kërkojnë shtetësinë shqiptare. Në vitin 2016 kanë fituar shtetësinë 281 shtetas të huaj. Krahasimi i të dhënave të viteve 2012 - 2015 tregon se pas rritjes në vitin 2014, në vitin 2015 dhe 2016 ka një ulje të ndjeshme të kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare nga të huajt. Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat mbi aplikimet për shtetësi shqiptare gjatë katër viteve të fundit.

Tabela 6.1. Aplikime për marrjen e shtetësisë shqiptare, 2015-2016

	2015	2016
Fitim shtetësie	257	281
Dhënie shtetësie	3	-
Njohje shtetësie	20	13
Rifitim shtetësie	23	13

Burimi: Drejtoria Juridike dhe e Përafrimit Legjislativ, Tiranë, 2017

7. Migracioni dhe zhvillimi

7.1. Autoritetet Përgjegjëse

Ministria e Punëve të Brendshme ka përgjegjësinë e përgjithshme në fushën e migracionit dhe Ministria e Punëve të Jashtme është përgjegjëse për komunitetet Shqiptare në vendet fqinje si dhe Diasporës jashtë vendit.

Nisur nga fakti së zhvillimi ekonomik i vendit është i lidhur drejtpërdrejtë me proceset migratore, një sërë ministrish, si: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; Ministria e Financave; Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; Ministria e Arsimit dhe Sporteve; etj., sipas fushës së veprimtarisë së tyre përfshijnë hartimin e politikave dhe strategjive të cilat direkt apo indirekt rregullojnë çështje që kanë të bëjnë me migrimin dhe zhvillimin.

7.2. Kuadri Ligjor

Qëllimi i përbashkët i autoriteteve përgjegjëse në fushën e migracionit dhe zhvillimi të vendit, është krijimi i një klime të favorshme për promovimin dhe tërheqjen e investimeve të huaja dhe nga diaspora. Në këtë kuadër, dërgesat në para të emigrantëve konsiderohen si element përbërës i investimeve të huaja direktet. Gjithashtu, një nga objektivat e qeverise shqiptare është zhvillimi i zonave të lira ekonomike ose zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

Një aspekt themelor i politikave të migracionit dhe zhvillimit është Dokumenti Politik për Angazhimin e Komuniteteve Shqiptare Jashtë Vendit. Kjo politikë është zhvilluar nisur nga vlerësimi që qeveria shqiptare po i bën gjithnjë e më tepër potencialit që kanë Komunitetet Shqiptare Jashtë Vendit (KSHJV) në zhvillimin social, kulturor, politik dhe ekonomik të Shqipërisë. Ajo përfaqëson një njohje të spikatur të KSHJV-ve si agjentë dhe partnerë zhvillimorë të rëndësishëm në të ardhmen e Shqipërisë.

Kjo është një politikë që ka për synim të bëjë të mundur vendosjen e lidhjeve dhe marrëdhënieve me përfitim të ndërsjellë ndërmjet Shqipërisë dhe komuniteteve të saj jashtë vendit. *Politika për Angazhimin e Komuniteteve Shqiptare Jashtë Vendit* është formalizimi i parë i një kuadri politikash për vendosjen e një marrëdhënieje me përfitim të ndërsjellë ndërmjet Shqipërisë dhe komuniteteve të saj jashtë vendit. Dokumenti u shpall në Samitin e parë të Diasporës që u zhvillua nga Qeveria Shqiptare në Nëntor 2016 dhe ku morën pjesë rreth 1 000 pjesëmarrës nga komunitetet shqiptare nga 40 vende të botës.

Dokumentet politik është i orientuar rreth katër komponentëve kryesorë:

- Komponenti 1 - Zhvillimi institucional
- Komponenti 2 - Komunitetet Shqiptare Jashtë Vendit dhe kapitali njerëzor
- Komponenti 3 - Komunitetet Shqiptare Jashtë Vendit dhe zhvillimi ekonomik
- Komponenti 4 - Mbështetja për Komunitetet Shqiptare Jashtë Vendit

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në kuadër të politikave zhvillimore, si dhe Ligjin nr 55/2015 "për Investimet e Strategjike", ka rol mbështetës dhe kontribuues në mënyrë indirekte në fushën e migracionit.

Qeveria Shqiptare gjatë vitit 2016 intensifikoi përpjekjet për të nxitur angazhimin e komuniteteve

shqiptare jashtë vendit në zhvillimin e Shqipërisë. Për këtë qëllim u hartua me mbështetjen teknike dhe financiare të Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), Dokumenti Politik për Angazhimin e Komuniteteve Shqiptare Jashtë Vendit. Plani i Veprimit i Dokumentit Politik parashikon një sërë masash konkrete për zbatim në një hark kohor tre vjeçar.

7.3. Statistika

Aktualisht prezenca e investimeve të huaja në Shqipëri nga pikëpamja e origjinës është si më poshtë:

- i. Investimet nga Greqia zinin vendin e parë, me një stok prej 1,23 miliardë euro në fund të vitit 2016, me një rritje prej 2% në raport me një vit më parë dhe të përqendruara në fushën e sektorit bankar dhe telekomunikacioneve.
- ii. Investimet nga Holanda zinin vendin e dytë me një stok prej 843 milionë euro, me rritje prej 23% në raport me një vit më parë dhe të përqendruara në fushën e energjisë dhe telekomunikacionit;
- iii. Investimet nga Kanadaja zinin vendin e tretë, me një stok prej 798 milionë euro, por me rënie prej 20% në raport me një vit më parë dhe të përqendruara në fushën e industrisë nxjerrëse të naftës.
- iv. Investimet nga Italia zinin vendin e katërt, me një stok prej 561 milionë euro, me rritje 3 % me bazë vjetore dhe të përqendruara në fushën e sektorit bankar dhe industrisë.
- v. Investimet nga Turqia zinin vendin e pestë, me një stok 531 milionë euro dhe rritje 18% me bazë vjetore dhe të përqendruara në fushën e telekomunikacionit, sektorit bankar dhe industrisë.
- vi. Investimet nga Austria zinin vendin e gjashtë , me një stok 424 milionë euro, me rritje prej 10%, në krahasim me një vit më parë dhe të përqendruara në shërbime financiare (sektori bankar dhe sigurime) dhe energji.

Nga pikëpamja e thithjes së investimeve të huaja direkt, kryesojnë sektorët e mëposhtëm:

- i. Informacioni dhe komunikacioni të cilët kanë stokun më të lartë të investimeve të huaja direkt, me një vlerë prej 1.24 miliardë euro në fund të vitit 2016;
- ii. Sektori i dytë më i rëndësishëm janë aktivitetet financiare dhe të sigurimit, stoku i investimeve të të cilit është 941 milionë euro;
- iii. Sektori i tretë është energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar, me një stok në vlerën 938 milionë euro.

Për vitin 2016 fluksi i Investimeve Direkt arriti vlerën 983 milionë euro.

Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, për vitin 2016, Shqipëria ka thithur më shumë Investime Direkte krahasuar me një vit më parë, me një rritje prej 10% , nga 890 milionë euro në vitin 2015 , në 983 milionë euro në vitin 2016. Investimet direkt në vitin 2016 përbënin 9% të PPB⁴. Sektori industrial (prodhimi, industria përpunuese dhe nxjerrëse) dhe sektori i energjisë ishin ndër sektorët kryesorë në thithjen e investimeve, me një vlerë prej 740 milionë euro në fluksin e ID. Disa industri me intensitet punësimi, siç janë industria e veshjeve dhe këpucëve kanë tërhequr një numër projektesh, por me sasi modeste kapitali. Të tjerë sektorë të rëndësishëm janë sektori i transportit dhe i shërbimeve financiare dhe të sigurimit. Zvicra kryesonte për vitin 2016 me një fluks investimesh prej rreth 429 milionë euro, e ndjekur nga Holanda me një vlerë prej 148 milionë euro, Kanadaja me 127 milionë euro dhe Turqia me 64 milionë euro.

⁴Referuar shifrës së PBB të parashikuar nga Ministria e Financave

Në fund të vitit 2013 u numëruan 3,046 ndërmarrje me pronësi të huaj që ushtrojnë aktivitet ekonomik në Republikën e Shqipërisë, ndërsa në vitin 2014 numërohen 3,478 ndërmarrje aktive. Viti 2015 shënoi një rritje krahasuar me dy vitet e mëparshme, duke numëruar 4,084 ndërmarrje të huaja. Për sa i përket ndërmarrjeve me pronësi të përbashkët (shqiptarë në bashkëpunim me të huaj), numri i tyre për vitin 2013 ishte 1,608, ndërsa për 2014 ishte 1,767 ndërmarrje aktive. Fundi i vitit 2015 numëron 1,855 ndërmarrje aktive me pronësi të huaja e të përbashkëta.

Gjatë viteve 2013-2015 në grupin e ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta vihet re se në 64% të tyre pala e huaj është mbizotëruese ndaj palës shqiptare.

Legjislacioni shqiptar⁵ detyron që regjistrimi i subjekteve në regjistrin tregtar përbën gjithashtu, regjistrimin e njëkohshëm të tyre pranë administratës tatimore, qendrore e vendore, në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe pranë inspektoratit të punës. Në vitin 2015 kishim 2,761 subjekte të kategorisë Punëdhënës, 2226 subjekte të kategorisë i vetëpunësuar me punëmarrës, 31921 subjekte të kategorisë i vetëpunësuar i vetëm dhe 53 subjekte të kategorisë i vetëpunësuar me punëmarrës dhe punonjës të papaguar të familjes.⁶ Për vitin 2016 paraqitet situata në Tabelën 7.1, sipas kategorisë së subjekteve:

Tabela 7.1. Subjekte tregtare sipas kategorisë, për vitin 2016

Kategoria e Subjektit	2016
I vetëpunësuar pa punëmarrës	2742
I vetëpunësuar me punëmarrës dhe pjesëtar të familjes të papaguar	5
I vetëpunësuar me punëmarrës	309
I vetëpunësuar pa punëmarrës dhe pjesëtarë të familjes të papaguar	202
Punëdhënës	451

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit, Tiranë, 2017

Në vitin 2015 ishin rreth 1058 ndërmarrje me pronarë të huaj, krahasuar me 3,500 ndërmarrje në vitin 2014. Diferenca tregon tendencën në ulje të investimeve nga të huajt. Tabela 7.2 paraqet të dhënat për vitin 2016 të subjekteve me pronësi të huaj.

Tabela 7.2. Subjekte me pronësi të huaj në Shqipëri, për vitin 2016

Pronësia	Total
Subjektet me pronësi të huaj	1203
Subjektet me pronësi të përbashkët	300

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit, Tiranë, 2017

Ndërmarrjet me pronarë apo bashkëpronarë të huaj zënë çdo vit rreth 4 % të ndërmarrjeve në vend. Rreth 81.2 % e ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta përqendrohet në qarqet Tiranë, Durrës dhe Vlorë, të cilat tërheqin shumicën e investitorëve të huaj.

⁵Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, Neni 59, pika 1.

⁶QKB- Qendra Kombëtare e Biznesit, i krijuar në bazë të Ligjit Nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", si rezultat i bashkimit të dy institucioneve, Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit

Tabela 7.3. Subjekte me pronësi të huaj, për vitin 2016

	Tiranë	Durrës	Vlorë
Subjektet me pronësi të huaj dhe të përbashkët	1240	214	87

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit, Tiranë, 2017

Gjithashtu, investitorët e huaj në Shqipëri operojnë kryesisht në aktivitetet e renditura në Tabelë.

Tabela 7.4. Subjekte me pronësi të huaj, sipas llojit të aktivitetit për vitin 2016

Emërtimi i Aktivitetit	2015	2016
Tregti me shumice dhe pakice riparim i automjeteve dhe motoçikletave	318	490
Informacioni dhe komunikacioni		114
Ndërtimi	83	131
Shërbime administrative dhe mbështetëse		153
Akomodim dhe shërbim		121
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	124	214
Industri përpunuese	108	191

Burimi: Qendra Kombëtare e Biznesit, Tiranë, 2017

Rritja reale e PBB është ndër treguesit më të rëndësishëm të llogarive kombëtare. Gjatë vitit 2016 ekonomia shqiptare shënoi një rritje reale prej 3.37 %, ndërsa në vitin 2015, rritja ekonomike ishte 2.23 % në terma real.⁷PBB për frymë në vitin 2015 arriti në 496 mijë lekë. Ndikimi i rritjes ekonomike në sistemin e mirëqenies dhe për rrjedhojë, edhe në prodhimin e flukseve migratore, lidhet me kontributin e degëve të ekonomisë në PBB dhe në punësim. Gjatë vitit 2016⁸kontributi kryesor në rritjen ekonomike erdhi nga shërbimet (46.8%), bujqësia (20.1%), ndërtimi (9.2%) dhe industria (11.6%).⁹ Ndërkohë, kontributi i sektorëve në punësim ishte shpërpjesëtimor, sidomos në rastin e bujqësisë dhe shërbimeve. Shërbime thithin një pjesë të vogël të forcës së punës të formatizuar, ndërkohë që rezultojnë ndër sektorët me informalitet shumë të lartë. Mungesa e vendeve të punës dhe informaliteti në ekonomi dhe në tregun e punës ushqejnë natyrshëm flukset migratore të shqiptarëve.

Diaspora shqiptare përbëhet aktualisht nga pesë grupe kryesore: i) emigrantët ekonomikë; ii) prestatët e familjeve të emigrantëve ekonomikë; iii) studentët; iv) azilkërkuesit dhe refugjatët; v) fëmijët e pashoqëruar. Grupet më të mëdha të Diasporës përbëhen nga emigrantët ekonomikë, pjesëtarët e familjeve të emigrantëve ekonomikë dhe studentët. Ndërkohe, megjithëse me ritme shumë më të ulëta, gjatë vitit 2016 vijoi fluksi i azilkërkuesve drejtë vendeve të BE-së, ku numrin më të madh e zini ata drejtë Gjermanisë.

Shqipëria vazhdon të ketë një varësi të lartë nga dërgesat e emigrantëve (remitancat). Prej vitit 2007, kur remitancat arritën nivelin më të lartë, 952 milionë Euro, dhe deri në vitin 2013 remitancat erdhën në rënie, duke arritur në këtë vit pikën më të ulët 547 milionë Euro, gjatë viteve në vazhdim kanë filluar relativisht të rriten . Gjatë vitit 2016 ka vazhduar trendi pozitiv në rritje në 616 milionë Euro.¹⁰


⁷INSTAT, Tiranë, 2017

⁸Të dhënat për vitin 2016 bazohen mbi vlerësimet tremujore

⁹INSTAT, Tiranë, 2017

¹⁰Banka e Shqipërisë

Figura 7.1. Dinamika e remitancape të emigrantëve shqiptarë, 2003-2016



Burimi: Banka e Shqipërisë 2017

Rënia e remitancape ka ndodhur për shkak të krizës në vendet pritëse, Greqi dhe Itali, por edhe për shkaqe të tjera: faturimi i procesit migrator, mplakja e brezit të parë të emigrantëve, rritja e shpenzimeve për brezin e dytë dhe të tretë të emigrantëve, kristalizim i projekteve migratore, rritja e kostos së shërbimeve publike dhe jetesës në vendet pritëse, modifikimi i sjelljes dhe projekteve individuale e familjare, për shkak të pasigurisë që shkakton kriza financiare, etj.

8. Azili dhe Mbrojtja ndërkombëtare

8.1. Autoritetet Përgjegjëse

Ministria e Punëve të Brendshme ka përgjegjësinë kryesore në fushën e migracionit dhe azilit. Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin është përgjegjës përzgjedhjen e të huajve të parregullt në kufi dhe territor.

Drejtoria për Azilin funksionon bazuar në Ligjin 121/2014 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë. Azilkërkuesi, pas paraqitjes së kërkesës për azil, akomodohet në qendrën pritëse për azilkërkuesit. Në këtë qendër akomodohen edhe personat, të cilët i është refuzuar aplikimi për azil, derisa të mbarojnë procedurat e ankimit apo afatet për ushtrimin e tyre. Azilkërkuesi ka të drejtë të qëndrojë në qendrën pritëse gjatë kohëzgjatjes së procedurës për marrjen e statusit të refugjatit. Në qoftë së azilkërkuesi ka mundësi të qëndrojë jashtë qendrës pritëse dhe përballon kushtet minimale të jetesës, Drejtoria e Azilit vendos largimin e azilkërkuesit nga kjo qendër;

8.2. Kuadri Ligjor

Republika e Shqipërisë, me qëllim të harmonizimit të legjislacionit tonë me Direktivat e BE-së, ka hartuar Ligjin Nr. 121/2014 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë" i cili parashikon kushtet dhe procedurat për dhënien dhe heqjen e statusit të refugjatit, mbrojtjen plotësuese dhe mbrojtjen e përkohshme në Republikën e Shqipërisë, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, refugjatëve e të personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese, përmbajtjen e statusit të refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese, të drejtën për bashkim familjar, si dhe përcaktimin e kushteve për integrimin e refugjatëve e të personave nën mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë.

Po kështu i sanksionuar në ligj është edhe parimi i moskthimit sipas të cilit:

1. Republika e Shqipërisë njeh dhe respekton detyrimin e autoriteteve për të mos kthyer a prapësuar, ekstraduar apo larguar jashtë territorit të saj personat që kanë përfutur apo kërkuar të drejtën e azilit apo të formave të tjera të mbrojtjes për këto raste:
 - a) në një shtet ku jeta apo liria e tyre kërcënohen për shkak të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo të bindjeve politike;
 - b) në një shtet ku ka arsye të besueshme së azilkërkuesi mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet torturës ose ndëshkimit çnjerëzor e degradues apo çdo trajtimi tjetër të parashikuar në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të interpretuar nga Gjykata Evropiane apo në traktatet/konventat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë;
 - c) në një shtet ku ka arsye të besueshme së azilkërkuesi mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet zhdukjes me forcë;
 - d) në shtetin e tyre të origjinës, në rast së të huajve u është dhënë një nga format e mbrojtjes, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
 - e) në një shtet të tretë, i cili mund ta kthejë ose ta dërgojë personin në një nga shtetet, sipas përcaktimeve të shkronjave "a", "b" dhe "c", të këtij neni.
2. I huaji, të cilit aplikimi për azil i është refuzuar nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, nuk dëbohet apo nuk nxirret jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë përpara ushtrimit apo

- dhënies së mundësive ligjore për ushtrimin e të drejtave procedurale dhe garancive të parashikuara në këtë ligj, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.
3. Për rastet përjashtimore, azilkërkuesi mund të kthehet kur:
- ka arsye të bazuara e të arsyetuara në vendim për ta konsideruar si një rrezik për sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë;
 - është dënuar me vendim të formës së prerë për një krim që dënohet minimalisht me 7 vjet burgim, i cili përbën një rrezik për rendin dhe sigurinë e Republikës së Shqipërisë.

Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët

Ky ligj parashikon edhe hallkën administrative të ankimit ndaj vendimeve të drejtorisë që përbën një garanci më tepër për azilkërkuesit dhe refugjatët. Në këtë ligj parashikohet se, Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët është autoriteti i vetëm kompetent vendimmarrës për ankimet kundër vendimeve të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

Në vitin 2016 u miratua VKM Nr. 206, datë 16.03.2016 për "Krijimin, Përbërjen, Organizimin dhe funksionimin e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët", ky Komision është plotësuar me anëtarët e saj.

Standardet e Pritjes

Ligji Nr. 121/2014 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë" është përafuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2003 /9/KE, datë 27 janar 2003 "Për përcaktimin e standardeve minimale për pritjen e azilkërkuesve". Në këtë kuadër u rikonstruktua Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkues, për të siguruar kushte edhe më të mira jetese në drejtim të akomodimit, kushteve të higjienës si edhe për të rritur kapacitetet pritëse.

8.3. Statistika

Gjatë vitit 2016 Shqipëria është evidentuar rritje e kërkesave për azil nga shtetas te huaj.

Dinamika e të huajve me mbrojtje ndërkombëtare, sipas shtetësisë, pa përfshirë shtetasit nga Irani të kampit ASHRAF, paraqitet në Tabelë:

Tabela 8.1. Të huaj azilkërkues sipas shtetësisë për vitet 2015-2016

Shtetësia/Viti	2015	2016
Kosove	1	1
Irak	1	28
Ukrainë	3	1
Eritrea	7	-
Iran	1	-
Sudan	4	-
Gambia	1	-
Turqi	-	2
Serbi	-	1
Somali	1	-
Gabon	1	-
Kamerun	2	-

Maqedoni	2	1
Afganistan	3	64
Siri	79	127
Pakistan	-	4
Kongo	-	3
Gana	-	1
Tunizi	-	3
Guine	-	2
Mali	-	1
Sudan	-	1
TOTAL	106	240

Burimi: Drejtoria për Azilin, Tiranë, 2017

Në tabelë paraqiten të dhëna mbi vendimet e pezullimit të kërkesave sipas shtetësisë.

Tabela 8.2. Vendime pezullimi sipas shtetësisë, 2015-2016

Shtetësia	2015	2016
Armeni	1	-
Kamerun	2	-
Gabon	1	-
Iran	1	-
Kosovë	1	-
Irak	-	1
Ukrainë	-	-
Eritrea	2	-
Sudan	-	-
Gambia	-	-
Liban	-	-
Serbi	-	1
Guine	-	2
Azerbajxhan	2	-
Afganistan	1	13
Siri	2	6
TOTAL	13	23

Burimi: Drejtoria për Azilin, Tiranë, 2017

Institucione kontribuuese:

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Drejtoria e Policisë së Shtetit

Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin

Drejtoria për Azilin

Drejtoria e Antitrafikut

MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Migratore

Shërbimi Kombëtar i Punësimit

INSTAT

BANKA E SHQIPËRISË

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Versioni Anglisht i Profilit të Migracionit 2016 u mundësua me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin IOM në Tiranë

Tirane 2017